LIGJ

Nr.10277, datë 13.5.2010

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E ROTERDAMIT "MBI PROCEDURËN E NJOFTIMIT TË PËLQIMIT PARAPRAK PËR DISA KIMIKATE DHE PRODUKTE TË RREZIKSHME PËR MBROJTJEN E BIMËVE NË TREGTINË NDËRKOMBËTARE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën e Roterdamit "Mbi procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërkombëtare".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6577, datë 25.5.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONVENTA E ROTERDAMIT

MBI PROCEDURËN E NJOFTIMIT TËPËLQIMIT PARAPRAK PËR DISA KIMIKATE DHE PRODUKTE PËR MBROJTJEN E BIMËVE TË RREZIKSHME NË TREGTINË NDËRKOMBËTARE TEKSTI DHE ANEKSET (Rishikuar në vitin 2005) UNEP

Palët e kësaj Konvente,

të ndërgjegjshme për ndikimin e dëmshëm në shëndetin e njeriut dhe mjedis të disa kimikateve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve të rrezikshme në tregtinë ndërkombëtare;

duke rikujtuar kushtet përkatëse të Deklaratës së Rios mbi mjedisin dhe zhvillimin, dhe kapitullin 19 të agjendës 21 "mbi miradministrimin nga pikëpamja mjedisore të kimikateve toksike, përfshirë parandalimin e trafikut të paligjshëm ndërkombëtar të produkteve toksike dhe të rrezikshme";

të ndërgjegjshme për punën e ndërmarrë nga programi për mjedisin i Kombeve të Bashkuara (UNEP) dhe Organizata për Bujqësinë dhe Ushqimin e Kombeve të Bashkuara (FAO) në funksionimin e procedurës së njoftimit të pëlqimit paraprak vullnetar, siç është përcaktuar në udhëzimet e ndryshuara të Londrës për shkëmbimin e informacionit mbi kimikatet në tregtinë ndërkombëtare të UNEP-it (në vijim i referuar si " Udhëzimet e ndryshuara të Londrës") dhe në Kodin Ndërkombëtar të Sjelljes të FAO-s mbi shpërndarjen dhe përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve (në vijim i referuar si " Kodi Ndërkombëtar i Sjelljes");

duke marrë në konsideratë rrethanat dhe kërkesat e veçanta të vendeve në zhvillim dhe të vendeve me ekonomi në tranzicion, në veçanti nevojën për forcimin e aftësive dhe kapaciteteve kombëtare për administrimin e kimikateve, përfshirë transferimin e teknologjisë me anë të dhënies së asistencës teknike dhe financiare dhe nxitjes së bashkëpunimit midis palëve;

duke vërejtur nevojat specifike të disa vendeve për informacion mbi lëvizjet transit; duke pranuar se praktikat për miradministrimin e kimikateve duhet të promovohen në të gjitha vendet, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera, standardet vullnetare të përcaktuara në Kodin Ndërkombëtar të Sjelljes dhe në Kodin e Etikës të UNEP-it mbi tregtinë ndërkombëtare të kimikateve;

duke dëshiruar të garantojnë se kimikatet e rrezikshme që importohen nga territoret e tyre janë paketuar dhe etiketuar në mënyrë të tillë që shëndeti i njerëzve dhe mjedisi të mbrohen në nivel të mjaftueshëm, në përputhje me parimet e Direktivave të ndryshuara të Londrës dhe Kodin Ndërkombëtar të Sjelljes;

duke pranuar se politikat e tregtisë dhe mjedisit duhet të mbështesin reciprokisht njëra- tjetrën, me qëllim arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm;

duke theksuar se asgjë në këtë Konventë nuk interpretohet sikur nënkupton në ndonjë mënyrë një ndryshim në të drejtat dhe detyrimet e një pale sipas ndonjë marrëveshjeje ekzistuese ndërkombëtare që zbatohet për kimikatet në tregtinë ndërkombëtare ose mbrojtjen e mjedisit;

duke kuptuar se pikat e mësipërme nuk synojnë të krijojnë një hierarki ndërmjet kësaj Konvente dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare;

të vendosur për të mbrojtur shëndetin e njerëzve, përfshirë shëndetin e konsumatorëve dhe punëtorëve, dhe mjedisin nga ndikimet potencialisht të dëmshme të disa kimikateve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve të rrezikshme në tregtinë ndërkombëtare, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Objektivi

Objektivi i kësaj Konvente është të nxisë përgjegjësinë e përbashkët dhe përpjekjet reciproke ndërmjet palëve në tregtinë ndërkombëtare të disa kimikateve të rrezikshme, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga dëmet e mundshme, si dhe kontributin në përdorimin e tyre të sigurt nga pikëpamja mjedisore, duke ndihmuar në shkëmbimin e informacionit rreth karakteristikave të tyre, duke parashikuar një proces vendimmarrjeje kombëtare mbi import- eksportin e tyre dhe duke ia transmetuar këto vendime palëve të Konventës.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të kësaj Konvente:

a) "Kimikat" nënkupton një substance qoftë më vete, ose në një përzierje apo preparat dhe i prodhuar ose i përftuar nga natyra, por që nuk përfshin ndonjë organizëm të gjallë. Ai përbëhet nga kategoritë e mëposhtme: produkte për mbrojtjen e bimëve (duke përfshirë formulat e produkteve për mbrojtjen e bimëve tepër të rrezikshme) dhe industriale.

b) "Kimikat i nda luar" nënkupton një kimikat, të gjitha përdorimet e të cilit, brenda një ose më shumë kategorive, janë ndaluar nga masa rregulluese përfundimtare, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njerëzve ose mjedisit. Ai përfshin një kimikat që nuk është miratuar për përdorim si lëndë e parë ose është hequr nga industria ose nga tregu i brendshëm, ose nga faktorë të mëtejshëm në procesin e brendshëm të miratimit dhe kur ka të dhëna të qarta se një masë e tillë është ndërmarrë për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve ose mjedisit.

c) "Kimikat rreptësisht i kufizuar" nënkupton një kimikat, të gjitha përdorimet e të cilit, brenda një ose më shumë kategorive, janë ndaluar nga masat rregulluese përfundimtare, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njerëzve ose mjedisit, por për të cilin lejohen disa përdorime specifike. Ai përfshin një kimikat që nuk është miratuar për të gjitha përdorimet ose është hequr nga industria, nga tregu i brendshëm ose nga faktorë të mëtejshëm në procesin e brendshëm të miratimit, dhe kur ka të dhëna të qarta se një masë e tillë është ndërmarrë për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve ose mjedisit.

d) "Formulë produkti për mbrojtjen e bimëve tepër i rrezikshëm" nënkupton një kimikat të formuluar për përdorim produkti për mbrojtjen e bimëve që sjell pasoja të dëmshme për shëndetin ose mjedisin, të cilat vërehen brenda një periudhe të shkurtër kohe, pas një ose disa ekspozimesh, sipas kushteve të përdorimit.

e) "Masë rregulluese përfundimtare" nënkupton një masë të ndërmarrë nga një palë, që nuk kërkon masë rregulluese të mëpasshme nga ajo palë, qëllimi i të cilit është të ndalojë ose kufizojë rreptësisht një kimikat.

f) "Eksport" dhe "import" nënkupton, në ngjyrimin e tyre përkatës gjuhësor, zhvendosjen e një kimikati nga një palë tek një palë tjetër, por përjashton operacionet e thjeshta të transitit.

g) "Palë" nënkupton një shtet ose organizatë rajonale e integrimit ekonomik që ka rënë dakord t'i përmbahet kësaj Konvente dhe për të cilën Konventa është në fuqi.

h) "Organizatë rajonale e integrimit ekonomik" nënkupton një organizatë të përbërë nga shtete sovrane të një rajoni të caktuar, së cilës shtetet anëtare i kanë kaluar kompetencën në lidhje me çështjet që rregullohen nga kjo Konventë dhe që është autorizuar siç duhet, në përputhje me procedurat e saj të brendshme, për të nënshkruar, ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në këtë Konventë.

i) "Komiteti i rishikimit të Kimikatit" nënkupton organin ndihmës të përmendur në paragrafin 6 të nenit 18.

Neni 3

Fusha e veprimit të Konventës

1. Kjo Konventë zbatohet ndaj:

a) kimikateve të ndaluara ose rreptësisht të kufizuara; dhe

b) formulave të produkteve për mbrojtjen e bimëve tepër të rrezikshme.

2. Kjo Konventë nuk zbatohet ndaj:

a) drogave narkotike dhe substancave psikotrope:

b) materialeve radioaktive;

c) mbetjeve;

d) armëve kimike;

e) prodhimeve farmaceutike, duke përfshirë ilaçet për njerëzit dhe ato veterinare

f) kimikateve që përdoren si aditivë ushqimorë;

g) ushqimeve;

h) kimikateve në sasi që nuk mund të cenojnë shëndetin e njerëzve ose mjedisin, me kusht që ato të importohen:

i) për qëllime kërkimore ose analizash; ose

ii) nga një individ për qëllimet e tij/të saj të përdorimit personal në sasi të arsyeshme për një përdorim të tillë.

Neni 4

Autoritetet kombëtare të caktuara

1. Çdo palë cakton një ose më shumë autoritete kombëtare që do të jenë të autorizuara të veprojnë në emër të tyre në përmbushjen e funksioneve administrative që kërkohen nga kjo Konventë.

2. Çdo palë kërkon të sigurojë që autoriteti ose autoritete të tilla të kenë burimet e mjaftueshme për të kryer me efektivitet detyrat e tyre.

3. Çdo palë i njofton Sekretariatit emrin dhe adresën e autoritetit ose autoriteteve, jo më vonë se data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Ajo njofton menjëherë Sekretariatin për ndonjë ndryshim të emrit ose adresës së autoritetit apo autoriteteve.

4. Sekretariati informon menjëherë palët për njoftimet që ai merr sipas paragrafit 3.

Neni 5

Procedurat për kimikatet e ndaluara ose rreptësisht të kufizuara

1. Çdo palë që ka miratuar një masë rregulluese përfundimtare njofton Sekretariatin me shkrim për një masë të tillë. Njoftimi do të bëhet sa më shpejt qe të jetë e mundur dhe, në çdo rast, jo më vonë se nëntëdhjetë ditë pas datës në të cilën masa rregulluese përfundimtare ka hyrë në fuqi dhe përmban informacionin që kërkohet nga shtojca I, kur është e mundur.

2. Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për të, çdo palë do të njoftojë Sekretariatin me shkrim për masat rregulluese përfundimtare që ka në fuqi në atë kohë, përveç rasteve kur çdo palë që ka dorëzuar njoftimet për masat rregulluese përfundimtare sipas Udhëzimeve të ndryshuara të Londrës ose Kodit Ndërkombëtar të Sjelljes nuk duhet t'i ridorëzojë këto njoftime.

3. Sekretariati do të verifikojë, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas marrjes së njoftimit sipas paragrafëve 1 dhe 2, nëse njoftimi përmban informacionin e kërkuar nga shtojca I. Nëse njoftimi përmban informacionin e kërkuar, Sekretariati do t'u dërgojë menjëherë palëve një përmbledhje të informacionit të marrë. Nëse njoftimi nuk përmban informacionin e kërkuar, Sekretariati do të informojë palën njoftuesen përputhje me rrethanat.

4. Sekretariati do t'u komunikojë palëve çdo gjashtë muaj një përmbledhje të informacionit të marrë në përputhje me paragrafët 1 dhe 2, duke përfshirë informacionin në lidhje me ato njoftime që nuk përmbajnë informacionin e kërkuar nga shtojca I.

5. Kur Sekretariati ka marrë të paktën një njoftim nga secili prej dy rajoneve të përfshira në njoftimin e pëlqimit paraprak në lidhje me një kimikat të veçantë, se është verifikuar që plotëson kërkesat e shtojcës I, ai do t'i dërgojë ato tek Komiteti i Rishikimit të Kimikateve. Përbërja e rajoneve të përfshira në njoftimin e pëlqimit paraprak përcaktohet në një vendim që do të miratohet me konsensus në mbledhjen e parë të konferencës së palëve.

6. Komiteti i Rishikimit të Kimikateve do të shqyrtojë informacionin e dhënë në njoftime të tilla dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në shtojcën II, i rekomandon konferencës së palëve nëse kimikati në fjalë duhet t'i nënshtrohet procedurës së njoftimit të pëlqimit paraprak, dhe rrjedhimisht të përfshihet në listë në shtojcën III.

Neni 6

Procedurat për formulat e produkteve për mbrojtjen e bimëve tepër të rrezikshme

Çdo palë, që është vend në zhvillim ose vend me ekonomi në trazicion dhe që po kalon probleme të shkaktuara nga formula produktesh për mbrojtjen e bimëve tepër të rrezikshme sipas kushteve të përdorimit në territorin e vet, mund t'i propozojë Sekretariatit listën e formulave të produkteve për mbrojtjen e bimëve tepër të rrezikshme në shtojcën III. Në hartimin e një propozimi, pala mund të shfrytëzojë ekspertizën teknike nga çdo burim përkatës. Propozimi përmban informacionin e kërkuar në pjesën e parë të shtojcës IV.

1. Sekretariati do të verifikojë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas marrjes së një propozimi sipas paragrafit I, nëse propozimi përmban informacionin e kërkuar nga pjesa I e shtojcës IV. Nëse propozimi përmban informacionin e kërkuar, Sekretariati do t'u dërgojë menjëherë palëve një përmbledhje të informacionit të marrë. Nëse propozimi nuk përmban informacionin e kërkuar, Sekretariati do të njoftojë palën njoftuese në përputhje me rrethanat.

2. Sekretariati mbledh informacionin plotësues të përcaktuar në pjesën 2 të shtojcës IV në lidhje me propozimin e paraqitur sipas paragrafit 2.

3. Kur kërkesat e paragrafëve 2 dhe 3 më sipër janë plotësuar në lidhje me një formulë të veçantë të produkteve për mbrojtjen e bimëve tepër të rrezikshme, Sekretariati i paraqet propozimin dhe informacionin që lidhet me të Komitetit të Rishikimit të Kimikateve.

4. Komiteti i Rishikimit të Kimikateve rishikon informacionin e dhënë në propozim dhe në informacionin plotësues të mbledhur, dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në pjesën 3 të shtojcës IV, i rekomandon Konferencës së Palëve nëse formula e produktit për mbrojtjen e bimëve tepër të rrezikshëm në fjalë duhet t'i nënshtrohet procedurës së njoftimit të pëlqimit paraprak dhe rrjedhimisht të përfshihet në listë në shtojcën III.

Neni 7

Përfshirja e kimikateve në listën e shtojcës III

1. Për çdo kimikat që Komiteti i Rishikimit të Kimikateve ka vendosur të rekomandojë për përfshirje në listën e shtojcës III, ai do të përgatisë një dokument udhëzues të projektvendimit. Ky dokument udhëzues i vendimit duhet të bazohet minimalisht në informacionin e përcaktuar në shtojcën I, ose sipas rastit, në shtojcën IV dhe të përfshijë informacionin mbi përdorimet e kimikatit në një kategori të ndryshme nga kategoria për të cilën zbatohet masa rregulluese përfundimtare.

2. Rekomandimi i përmendur në paragrafin I bashkë me dokumentin udhëzues të projektvendimit i paraqitet Konferencës së Palëve. Konferenca e Palëve vendos nëse kimikati do t'i nënshtrohet procedurës së njoftimit të pëlqimit paraprak dhe rrjedhimisht të përfshihet në listën e shtojcës III dhe të miratojë dokumentin udhëzues të projektvendimit.

3. Pas marrjes së vendimit për të përfshirë kimikatin në listën e shtojcës III dhe miratimit nga Konferenca e Palëve të dokumentit udhëzues të vendimit që lidhet me të, Sekretariati do t'ua komunikojë menjëherë këtë informacion të gjitha palëve.

Neni 8

Kimikatet e përfshira në procedurën vullnetare të njoftimit të pëlqimit paraprak

Për çdo kimikat të ndryshëm nga një kimikat të renditur në listën e shtojcës III, që është përfshirë në procedurën vullnetare të njoftimit të pëlqimit paraprak para datës së mbledhjes së parë të Konferencës së Palëve, Konferenca e Palëve do të vendosë në atë mbledhje ta përfshijë kimikatin në listën e shtojcës III, me kusht që të sigurohet se i plotëson të gjitha kërkesat për t'u përfshirë në listën e asaj shtojce.

Neni 9

Heqja e kimikateve nga shtojca III

1. Nëse një pa lë i dorëzon Sekretariatit informacionin që nuk ishte në dispozicion në kohën e marrjes së vendimit për të përfshirë një kimikat në listën e shtojcës III, dhe informacioni tregon se përfshirja e tij në listë nuk justifikohet sipas kritereve përkatëse të shtojcës II, ose sipas rastit, të shtojcës IV, Sekretariati ia paraqet informacionin Komitetit të Rishikimit të Kimikateve.

2. Komiteti i Rishikimit të Kimikateve shqyrton informacionin që merr sipas paragrafit 1. Për çdo kimikat që Komiteti i Rishikimit të Kimikateve vendos, në përputhje me kriteret përkatëse të shtojcës II ose sipas rastit, të shtojcës IV, të rekomandojë heqjen nga shtojca III, ai përgatit një dokument udhëzues të projektvendimit të rishikuar.

3. Rekomandimi i përmendur në paragrafin 2, i paraqitet Konferencës së Palëve dhe shoqërohet nga dokumenti udhëzues i projektvendimit të rishikuar. Konferenca e Palëve vendos nëse kimikati do të hiqet nga shtojca III dhe nëse do të miratojë dokumentin udhëzues të projektvendimit të rishikuar.

4. Pas marrjes së vendimit për të hequr kimikatin nga shtojca III dhe miratimit të dokumentit udhëzues të projektvendimit të rishikuar nga Konferenca e Palëve, Sekretariati ua komunikon menjëherë këtë informacion të gjitha palëve.

Neni 10

Detyrimet në lidhje me importet e kimikateve të renditura në shtojcën III

1. Çdo palë zbaton masat përkatëse legjislative dhe administrative për të siguruar në kohën e duhur vendimet në lidhje me importet e kimikateve të listës së shtojcës III.

2. Çdo palë i transmeton Sekretariatit, sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe në çdo rast, jo më vonë se nëntë muaj pas datës së dërgimit të dokumentit udhëzues të vendimit të përmendur në paragrafin 3 të nenit 7, një përgjigje në lidhje me të ardhmen e importit të kimikatit në fjalë. Nëse një palë e ndryshon këtë përgjigje, ajo i dorëzon menjëherë Sekretariatit përgjigjen e rishikuar.

3. Sekretariati, me skadimin e periudhës kohore të parashikuar në paragrafin 2, i drejton menjëherë palës që nuk ka dhënë një përgjigje të tillë, një kërkesë me shkrim për ta bërë këtë. Nëse pala nuk është e aftë të japë një përgjigje, Sekretariati do ta ndihmojë atë, sipas rastit, të japë një përgjigje brenda periudhës kohore të përcaktuar në fjalinë e fundit të paragrafit 2 të nenit 11.

4. Një përgjigje sipas paragrafit 2 konsiston ose në:

a) një vendim të formës së prerë në përputhje me masat legjislative ose administrative:

i) për të dhënë pëlqimin për import;

ii) për të mos dhënë pëlqimin për import; ose

iii) për të dhënë pëlqimin për import vetëm duke iu nënshtruar kushteve të specifikuara; ose

b) një përgjigje të përkohshme, e cila mund të përfshijë :

i) një vendim të përkohshëm që jep pëlqimin për të importuar me ose pa kushte të specifikuara, ose për të mos dhënë pëlqimin për të importuar gjatë periudhës së përkohshme;

ii) një deklaratë që vendimi i formës së prerë është nën shqyrtim aktiv;

iii) një kërkesë Sekretariatit ose Palës që ka njoftuar mbi masën rregulluese përfundimtare, për informacione të mëtejshme;

vi) një kërkesë për ndihmë në vlerësimin e kimikatit drejtuar Sekretariatit.

5. Një përgjigje sipas nënparagrafëve (a) ose (b) të paragrafit 4 lidhet me kategorinë ose kategoritë e përcaktuara për kimikatin në shtojcën III.

6. Një vendim i formës së prerë shoqërohet me një përshkrim të çdo mase legjislative ose administrative mbi të cilën ai është bazuar.

7. Çdo palë, jo më vonë se data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për të, i dërgon Sekretariatit përgjigjet në lidhje me çdo kimikat të listës së shtojcës III. Një palë që ka dhënë përgjigje të tilla sipas direktivave të ndryshuara të Londrës ose Kodit Ndërkombëtar të Sjelljes nuk i ridërgon ato përgjigje.

8. Çdo palë jep përgjigjet e veta sipas këtij neni në dispozicion të palëve të interesuara brenda juridiksionit të vet, në përputhje me masat e saj legjislative ose administrative.

9. Një palë që, në përputhje me paragrafët e mësipërm 2 dhe 4, dhe paragrafin 2 të nenit 11, merr një vendim për të mos dhënë pëlqimin për importin e një kimikati, ose për të dhënë pëlqimin e importit të

tij vetëm sipas kushteve të specifikuara, njëkohësisht do të ndalojë ose do t'ia nënshtrojë kushteve të njëjta, nëse nuk e ka bërë tashmë një gjë të tillë:

a) importimin e kimikatit nga çdo burim; dhe

b) prodhimin në vend të kimikatit për përdorim të brendshëm.

10. Çdo gjashtë muaj Sekretariati informon të gjitha palët për përgjigjet që ai ka marrë. Një informim i tillë përfshin një përshkrim të masave legjislative ose administrative mbi të cilat është bazuar vendimi, kur është e mundur. Përveç kësaj, Sekretariati informon palët për çdo rast të mosdërgimit të një përgjigjeje.

Neni 11

Detyrimet në lidhje me eksportin e kimikateve të renditura në shtojcën III

1. Çdo palë eksportuese:

a) Zbaton masat legjislative dhe administrative përkatëse për t'i komunikuar përgjigjet e paraqitura nga Sekretariati në përputhje me paragrafin 10 të nenit 10 palëve të interesuara brenda jur idiksionit të vet;

b) Merr masat legjislative dhe administrative përkatëse për të siguruar që eksportuesit të veprojnë brenda juridiksionit në përputhje me vendimet për çdo përgjigje jo më vonë se gjashtë muaj pas datës në të cilën Sekretariati informon për herë të parë palët për një përgjigje të tillë, në përputhje me paragrafin 10 të nenit 10;

c) Këshillon dhe ndihmon palët importuese sipas kërkesës dhe kur është e mundur:

(i) për të marrë informacion të mëtejshëm për t'i ndihmuar ata të ndërmarrin masa, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 10 dhe paragrafit 2 (c) më poshtë; dhe

(ii) për të forcuar aftësitë dhe kapacitetet e tyre për të administruar kimikatet në mënyrë të sigurt gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre.

2. Çdo palë garanton që një kimikat i renditur në shtojcën III të mos eksportohet nga territori i vet tek ndonjë palë importuese që, në raste të veçanta nuk ka arritur të dërgojë një përgjigje, ose ka dërguar një përgjigje të përkohshme që nuk përmban një vendim të përkohshëm, nëse nuk:

a) është një kimikat që në kohën e importit, është regjistruar si kimikat i palës importuese;ose

b) është një kimikat për të cilin ka të dhëna se është përdorur më parë, ose importuar te pala importuese, dhe në lidhje me të cilin nuk është ndërmarrë ndonjë masë rregulluese për të ndaluar përdorimin e tij; ose

c) është kërkuar dhe marrë nga eksportuesi pëlqimi i hapur për të importuar përmes një autoriteti kombëtar të caktuar të Palës importuese. Pala importuese i përgjigjet një kërkese të tillë brenda gjashtëdhjetë ditësh dhe njofton menjëherë Sekretariatin për vendimin e saj.

Detyrimet e palëve eksportuese sipas këtij paragrafi do të jenë në fuqi prej datës së mbarimit të periudhës gjashtë mujore nga data në të cilën Sekretariati informon për herë të parë Palët, në përputhje me paragrafin 10 të nenit 10, se pala nuk ka arritur të dërgojë një përgjigje ose ka dërguar një përgjigje të përkohshme që nuk përmban një vendim të përkohshëm dhe aplikohet për një vit.

Neni 12

Njoftimi i eksportit

1. Kur një kimikat i ndaluar ose i kufizuar rreptësisht nga një palë eksportohet nga territori i saj, ajo palë njofton palën importuese në lidhje me eksportin. Njoftimi i eksportit përfshin informacionin e përcaktuar në shtojcën V.

2. Njoftimi i eksportit për atë kimikat bëhet para eksportit të parë pas miratimit të masës rregulluese përfundimtare korresponduese të eksportit. Pas kësaj, njoftimi i eksportit bëhet para eksportit të parë në çdo vit kalendarik. Kërkesa për njoftim para eksportit mund të mos merret parasysh nga autoriteti kombëtar i caktuar i palës importuese.

3. Një palë eksportuese bën një njoftim të përditësuar për eksportin pasi të ketë miratuar masën rregulluese përfundimtare që çon në një ndryshim thelbësor në lidhje me ndalimin ose kufizimin e rreptë të atij kimikati.

4. Pala importuese konfirmon marrjen e njoftimit të parë për eksportin pas miratimit të masës rregulluese përfundimtare. Nëse pala eksportuese nuk merr njoftimin brenda tridhjetë ditëve të dërgimit të njoftimit për eksportin, ajo dërgon një njoftim të dytë. Pala eksportuese bën përpjekje të arsyeshme për të garantuar që pala importuese të marrë njoftimin e dytë.

5. Detyrimet e një pale të përcaktuara në paragrafin 1 ndërpriten kur:

a) kimikati është renditur në shtojcën III;

b) pala importuese ka dhënë përgjigje për kimikatin tek Sekretariati, në përputhje me paragrafin 2 të nenit 10; dhe

c) Sekretariati i ka dërguar përgjigje palëve në përputhje me paragrafin 10 të nenit 10.

Neni 13

Informacioni që shoqëron kimikatet e eksportuara

1. Konferenca e palëve inkurajon Organizatën Botërore të Doganave për të caktuar kode doganore të sistemeve të harmonizuara për kimikate të veçanta ose grupe kimikatesh të listës në shtojcën III, sipas rastit. Çdo palë kërkon që, kurdoherë që një kod caktohet për kimikatet, dokumenti i transportit për atë kimikat të mbajë kodin gjatë eksportimit.

2. Pa cenuar kërkesat e palës importuese, çdo palë kërkon që kimikatet e renditura në shtojcën III dhe kimikatet e ndaluara ose rreptësisht të kufizuara në territorin e tyre, të marrin në konsideratë standardet ndërkombëtare përkatëse gjatë eksportimit, duke iu nënshtruar kërkesave të etiketimit që garantojnë vënien në dispozicion të informacionit në lidhje me rrezikun ndaj shëndetit të njerëzve ose mjedisit.

3. Pa cenuar kërkesat e palës importuese, çdo palë mund të kërkojë që kimikatet të cilat i nënshtrohen kërkesave të etiketimit shëndetësor dhe mjedisor në territorin e tyre, të marrin në konsideratë standardet ndërkombëtare përkatëse gjatë eksportimit, duke iu nënshtruar kërkesave të etiketimit që garantojnë vënien në dispozicion të informacionit në lidhje me rrezikun ndaj shëndetit të njerëzve dhe mjedisit.

4. Për sa i përket kimikateve të përmendura në paragrafin 2 që duhet të përdoren për qëllime profesionale, çdo palë eksportuese kërkon që çdo importuesi t'i dërgohet një fletë të dhënash sigurie sipas një formati të njohur ndërkombëta r, ku të vihet në dispozicion informacioni më i fundit.

5. Në rastet kur është e mundur, informacioni në etiketë dhe në fletën e të dhënave të sigurisë duhet të jepet në një ose më shumë gjuhë zyrtare të palës importuese.

Neni 14

Shkëmbimi i informacionit

1. Çdo palë, sipas rastit dhe në përputhje me objektivin e kësaj Konvente, lehtëson:

a) shkëmbimin e informacionit shkencor, teknik, ekonomik dhe ligjor në lidhje me kimikatet brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente, duke përfshirë informacionin toksikologjik, ekotoksikologjik dhe të sigurisë;

b) sigurimin e informacionit në dispozicion të publikut mbi masat rregulluese të brendshme që kanë lidhje me objektivat e kësaj Konvente; dhe

c) dhënien e informacionit palëve të tjera, drejtpërdrejt ose përmes Sekretariatit, mbi masat rregulluese të brendshme që kufizojnë në nivel të konsiderueshëm një ose më shumë përdorime të kimikatit, sipas rastit.

2. Palët që shkëmbejnë informacione sipas kësaj Konvente ruajnë fshehtësinë e çdo informacioni sipas marrëveshjeve të ndërsjella.

3. Informacionet e mëposhtme nuk konsiderohen konfidenciale për qëllimet e kësaj Konvente:

a) Informacioni i përmendur në shtojcat I dhe IV, i dorëzuar përkatësisht sipas neneve 5 dhe 6;

b) Informacioni që përmban fleta e të dhënave të sigurisë, i përmendur në paragrafin 4 të nenit 13;

c) Data e skadencës së kimikatit;

d) Informacioni mbi masat parandaluese, duke përfshirë klasifikimin e rrezikut, natyrën e rrezikut dhe konsulencën përkatëse të sigurisë; dhe

e) Rezultatet përmbledhëse të testeve toksikologjike dhe ekotoksikologjike.

4. Data e prodhimit të kimikatit përgjithësisht nuk konsiderohet konfidenciale për qëllimet e kësaj Konvente.

5. Çdo palë që kërkon informacion mbi lëvizjet transit përmes territorit të saj të kimikatit të renditur në shtojcën III, mund të raportojë këtë nevojë tek Sekretariati, i cili njofton të gjitha palët e tjera në përputhje me rrethanat.

Neni 15

Zbatimi i Konventës

1. Çdo palë merr masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të krijuar dhe forcuar infrastrukturën dhe institucionet përkatëse kombëtare për zbatimin efektiv të kësaj Konvente. Këto masa mund të përfshijnë, sipas kërkesës, miratimin ose ndryshimin e masave legjislative dhe administrative kombëtare dhe mund të përfshijnë gjithashtu:

a) krijimin e regjistrave dhe bazës së të dhënave kombëtare, duke përfshirë informacionin e sigurisë për kimikatet;

b) nxitjen e iniciativave nga industria për të promovuar sigurinë e kimikatit; dhe

c) promovimin e marrëveshjeve vullnetare, duke marrë në konsideratë dispozitat e nenit 16.

2. Çdo palë garanton, në masën e zbatueshme, që publiku të ketë aksesin përkatës në informacionin mbi trajtimin e kimikateve dhe menaxhimin e aksidenteve, si dhe mbi alternativat që janë më të sigurta për shëndetin e njerëzve ose mjedisin sesa kimikatet e renditura në shtojcën III.

3. Palët bien dakord të bashkëpunojnë, drejtpërdrejt ose kur është e nevojshme, përmes organizmave ndërkombëtare kompetente, për zbatimin e kësaj Konvente në nivelet nënrajonale, rajonale dhe globale.

4. Asgjë në këtë Konventë nuk interpretohet si kufizim i të drejtës së Palëve për të marrë masa që janë rreptësisht më mbrojtëse për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin sesa ato të cilat kërkohen në këtë Konventë, me kusht që këto masa të jenë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente dhe të drejtën ndërkombëtare.

Neni 16

Asistenca teknike

Palët, duke marrë parasysh veçanërisht nevojat e vendeve në zhvillim dhe vendeve me ekonomi në tranzicion, bashkëpunojnë për promovimin e asistencës teknike në lidhje me zhvillimin e infrastrukturës dhe kapacitetit të nevojshëm në administrimin e kimikateve për të bërë të mundur zbatimin e kësaj Konvente. Palët me programe më të avancuara për rregullimin e kimikateve duhet t'i ofrojnë asistencë teknike, duke përfshirë trajnimin, palëve të tjera për zhvillimin e infrastrukturës dhe kapacitetit të tyre në administrimin e kimikateve gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre.

Neni 17

Papajtueshmëria

Konferenca e palëve, sa më shpejt që të jetë e mundur, zhvillon dhe miraton procedurat dhe mekanizmat institucionalë për përcaktimin e papajtueshmërisë me dispozitat e kësaj Konvente dhe për trajtimin e palëve që konstatohen se nuk veprojnë në përputhje me të.

Neni 18

Konferenca e palëve

1. Për këtë krijohet një konferencë e palëve.

2. Mbledhja e parë e konferencës së palëve zhvillohet nga drejtori ekzekutiv i UNEP-it dhe drejtori i përgjithshëm i FAO-s, duke vepruar bashkërisht, jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Pas kësaj, mbledhjet e zakonshme të konferencës së palëve zhvillohen në periudha kohore të rregullta që përcaktohen nga konferenca.

3. Mbledhjet e jashtëzakonshme të konferencës së palëve zhvillohen në periudha kohore të tjera, siç mund të çmohet e nevojshme nga konferenca, ose me kërkesën me shkrim të një pale, me kusht që të mbështeten nga të paktën një e treta e palëve.

4. Konferenca e pal ëve bie dakord dhe miraton me konsensus në mbledhjen e saj te parë rregullat e procedurës dhe rregullat financiare për vete dhe për ndonjë organ ndihmës, si dhe dispozitat financiare që rregullojnë funksionimin e Sekretariatit.

5. Konferenca e palëve mban nën shqyrtim dhe vlerësim të vazhdueshëm zbatimin e kësaj Konvente. Ajo përmbush funksionet që i janë caktuar nga Konventa dhe për këtë qëllim:

a) krijon, në vijim të kërkesave të paragrafit 6 më poshtë, organe ndihmëse që i çmon të nevojshme për zbatimin e Konventës;

b) bashkëpunon, sipas rastit, me organizata ndërkombëtare kompetente dhe organe ndërqeveritare dhe joqeveritare; dhe

c) merr në konsideratë dhe ndërmerr çdo masë plotësuese që mund të kërkohet për arritjen e objektivave të Konventës.

6. Konferenca e palëve, në mbledhjen e saj të pare, krijon një organ ndihmës të quajtur Komiteti i Rishikimit të Kimikateve, me qëllim përmbushjen e funksioneve të caktuara atij Komiteti nga kjo Konventë. Në këtë drejtim:

a) Anëtarët e Komitetit të Rishikimit të Kimikateve caktohen nga konferenca e palëve. Anëtarësia e Komitetit përbëhet nga një numër i kufizuar ekspertësh në administrimin e kimikateve të caktuar nga qeveritë. Anëtarët e Komitetit emërohen mbi bazën e shpërndarjes së barabartë gjeografike, duke përfshirë sigurimin e një ekuilibri ndërmjet palëve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim;

b) Konferenca e palëve vendos në lidhje me termat e referencës, organizimin dhe funksionimin e Komitetit;

c) Komiteti bën çdo përpjekje për të bërë rekomandimet e tij me konsensus. Nëse bëhen të gjitha përpjekjet për konsensus dhe ai nuk arrihet, rekomandime të tilla, si mjet i fundit, miratohen me shumicë votash prej dy të tretave të anëtarëve të pranishëm që votojnë.

7. Kombet e Bashkuara, agjencitë e tyre të specializuara dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, si dhe çdo shtet jo palë në këtë Konventë, mund të përfaqësohen në mbledhjet e Konferencës së palëve si vëzhgues. Çdo organ ose agjenci, qoftë kombëtare ose ndërkombëtare, qeveritare ose

joqeveritare, e kualifikuar në çështjet e trajtuara në këtë Konventë dhe që ka informuar Sekretariatin mbi dëshirën për t'u përfaqësuar në mbledhjen e Konferencës së Palëve si vëzhgues, mund të pranohet nëse të paktën një e treta e palëve të pranishme nuk e kundërshton këtë. Pranimi dhe pjesëmarrja e vëzhguesve u nënshtrohet rregullave të procedurës të miratuara nga Konferenca e Palëve.

Neni 19

Sekretariati

1. Për këtë ngrihet Sekretariati.

2. Funksionet e Sekretariatit janë:

a) Të organizojë mbledhjet e Konferencës së Palëve dhe organeve ndihmëse të saj dhe t'u ofrojë atyre shërbimet e kërkuara;

b) Të lehtësojë ndihmën për Palët, veçanërisht për Palët në zhvillim dhe Palët me ekonomi në tranzicion, sipas kërkesës, në zbatimin e Konventës;

c) Të sigurojë bashkërendimin e nevojshëm me sekretariatet e organizmave të tjera përkatëse ndërkombëtare;

d) Të hyjë në marrëveshje të tilla administrative dhe kontraktuale që mund të nevojiten për përmbushjen efektive të funksioneve të tij sipas udhëzimeve të përgjithshme të Konferencës së Palëve;

e) Të përmbushë funksionet e tjera të sekretariatit të specifikuara në këtë Konventë dhe funksionet e tjera që mund të jenë përcaktuar nga Konferenca e Palëve.

3. Funksionet e Sekretariatit për këtë Konventë përmbushen bashkërisht nga drejtori ekzekutiv i UNEP-it dhe drejtori i përgjithshëm i FAO-s, sipas marrëveshjeve të tilla që miratohen ndërmjet tyre dhe nga Konferenca e Palëve.

4. Konferenca e Palëve mund të vendosë me tri të katërtat e shumicës së palëve të pranishme dhe që votojnë, për t'i besuar funksionet e sekretariatit një ose me shumë organizatave të tjera kompetente ndërkombëtare, në rast se çmon që Sekretariati nuk po funksionon si duhet.

Neni 20

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët zgjidhin çdo mosmarrëveshje midis tyre për sa i përket interpretimit dhe zbatimit të kësaj Konvente nëpërmjet negocimit ose mjeteve të tjera paqësore të zgjedhura prej tyre.

2. Gjatë ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, ose në çdo kohë të mëpasshme, një palë që nuk është organizatë rajonale e integrimit ekonomik mund të deklarojë në një instrument me shkrim të dorëzuar tek depozitari se, për sa i përket ndonjë mosmarrëveshjeje mbi interpretimin dhe zbatimin e kësaj Konvente, ajo pranon një ose të dyja mjetet e mëposhtme të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve si të detyrueshme në lidhje me çdo palë që pranon të njëjtin detyrim.

a) Arbitrazhi në përputhje me procedurat që duhet të miratohen nga Konferenca e Palëve në një shtojcë sa më shpejt që të jetë e mundur; dhe

b) Paraqitja e mosmarrëveshjeve në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

3. Një palë që është organizatë rajonale e integrimit ekonomik mund të bëjë një deklaratë me efekt të njëjtë në lidhje me arbitrazhin në përputhje me procedurën e përmendur në paragrafin 2 (a).

4. Një deklaratë e bërë në përputhje me paragrafin 2 mbetet në fuqi brenda afatit te saj ose deri në tre muaj pasi njoftimi me shkrim për revokimin e saj të jetë depozituar te depozitari.

5. Skadimi i afatit të një deklarate, njoftimi për revokim ose një deklarate të re nuk ndikon në asnjë mënyrë në procedimet e mbetura pezull para një gjykate arbitrazhi ose Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, nëse palët e mosmarrëveshjes nuk bien dakord ndryshe.

6. Nëse palët e një mosmarrëveshjeje nuk kanë pranuar të njëjtën procedurë ose ndonjë procedurë sipas paragrafit 2 dhe nëse nuk kanë mundur ta zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre brenda dymbëdhjetë muajve pas njoftimit nga një palë për tjetrën se ekziston një mosmarrëveshje ndërmjet tyre, mosmarrëveshja paraqitet tek një komision pajtimi me kërkesë të çdo pale të mosmarrëveshjes. Komisioni i pajtimit të mosmarrëveshjeve jep një raport me rekomandime. Procedurat e mëtejshme që lidhen me komisionin e pajtimit të mosmarrëveshjeve përfshihen në një shtojcë që miratohet nga Konferenca e Palëve jo më vonë se mbledhja e dytë e Konferencës.

Neni 21

Amendamentet e Konventës

1. Amendamentet e kësaj Konvente mund të propozohen nga secila palë.

2. Amendamentet e kësaj Konvente miratohen në mbledhjen e Konferencës së Palëve. Teksti i çdo amendamenti të propozuar i komunikohet Palëve nga Sekretariati të paktën gjashtë muaj para mbledhjes në të cilën ai amendament është propozuar për miratim. Sekretariati i komunikon gjithashtu amendamentin e propozuar nënshkruesve të kësaj Konvente dhe për informacion depozitarit.

3. Palët bëjnë çdo përpjekje për të arritur marrëveshje me konsensus për çdo amendament të propozuar të kësaj Konvente. Nëse janë bërë të gjitha përpjekjet për arritjen e konsensusit dhe nuk arrihet marrëveshja, amendamenti miratohet si mjet i fundit me shumice votash prej tre te katërtave të palëve të pranishme që votojnë në mbledhje.

4. Amendamenti i komunikohet nga depozitari të gjitha palëve për ratifikim, pranim ose miratim.

5. Ratifikimi, pranimi ose miratimi i një amendamenti njoftohet me shkrim nga depozitari. Një amendament i miratuar në përputhje me paragrafin 3 hyn në fuqi për palët që e kanë pranuar atë në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit nga të paktën tri të katërtat e palëve. Më pas, amendamenti hyn në fuqi për çdo palë tjetër ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën ajo palë depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit të amendamentit.

Neni 22

Miratimi dhe ndryshimi i shtojcave

1. Shtojcat e kësaj Konvente formojnë pjesë përbërëse të saj dhe, nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe, një referencë ndaj kësaj Konvente përbën njëkohësisht një referencë ndaj çdo shtojce të saj.

2. Shtojcat kufizohen tek çështjet procedurale, shkencore, teknike ose administrative.

3. Procedura e mëposhtme zbatohet për propozimin, miratimin dhe hyrjen në fuqi të shtojcave plotësuese të kësaj Konvente:

a) Shtojcat plotësuese propozohen dhe miratohen në përputhje me procedurën e përcaktuar në paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 21;

b) Çdo palë që nuk mund të pranojë një shtojcë plotësuese njofton me shkrim depozitarin brenda një viti nga data e komunikimit të miratimit të shtojcës plotësuese nga depozitari. Depozitari njofton pa vonesë të gjitha palët për çdo njoftim të tillë të marrë. Një palë mund të tërheq në çdo kohë një njoftim të mëparshëm të mospranimit në lidhje me një shtojcë plotësuese dhe pas kësaj shtojca hyn në fuqi për atë palë sipas nënparagrafit (c) më poshtë; dhe

c) Me kalimin e afatit njëvjeçar pas datës së komunikimit nga depozitari të miratimit të një shtojce plotësuese, shtojca hyn në fuqi për të gjitha palët që nuk kanë dorëzuar njoftim në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (b) më sipër.

4. Me përjashtim të shtojcës III, propozimi, miratimi dhe hyrja në fuqi e amendamenteve të shtojcave të kësaj Konvente i nënshtrohen procedurave të njëjta si për propozimin, miratimin dhe hyrjen në fuqi të shtojcave plotësuese të kësaj Konvente.

5. Procedurat e mëposhtme zbatohen për propozimin, miratimin dhe hyrjen në fuqi të amendamenteve të shtojcës III:

a) Amendamentet e shtojcës III propozohen dhe miratohen sipas procedurës së përcaktuar në nenet 5 deri 9 dhe paragrafin 2 të nenit 21;

b) Konferenca e Palëve merr vendimet për miratim me konsensus;

c) Një vendim për ndryshimin e shtojcës III i komunikohet menjëherë palëve nga depozitari. Amendamenti hyn në fuqi për të gjitha palët në datën e përcaktuar në vendim.

6. Nëse një shtojcë plotësuese ose një amendament i një shtojce lidhet me amendimin e kësaj Konvente, shtojca plotësuese ose amendamenti nuk hyjnë në fuqi deri në kohën që amendamenti i kësaj Konvente të hyjë në fuqi.

Neni 23

Votimi

1. Çdo palë e kësaj Konvente ka një votë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 2 më poshtë;

2. Një organizatë rajonale e integrimit ekonomik, për çështjet brenda kompetencave të saj, ushtron të drejtën e saj të votës me një numër votash të barabartë me numrin e shteteve të saj anëtare që janë palë n ë këtë Konventë. Një organizatë e tillë nuk ushtron të drejtën e saj të votës nëse ndonjë shtet anëtar i saj ushtron të drejtën për të votuar dhe anasjelltas.

3. Për qëllime të kësaj Konvente "Palët e pranishme që marrin pjesë në votim" nënkupton palët e pranishme që votojnë pro ose kundër.

Neni 24

Nënshkrimi

Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim në Roterdam nga të gjitha shtetet dhe organizatat rajonale te integrimit ekonomik më 11 shtator 1998 dhe në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork nga 12 shtatori 1998 deri ne 10 shtator 1999.

Neni 25

Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi

1. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet dhe organizatat rajonale te integrimit ekonomik. Ajo do të jetë e hapur për aderim nga shtetet dhe organizatat rajonale të integrimit ekonomik nga dita pas datës në të cilën kjo Konventë mbyllet për nënshkrim. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen te depozitari.

2. Çdo organizatë rajonale e integrimit ekonomik që bëhet palë e kësaj Konvente pa ndonjë prej shteteve anëtare të saj si palë, i përmbahet të gjitha detyrimeve sipas Konventës. Në rastin e organizatave të tilla, ku një ose më shumë prej shteteve anëtare të saj janë palë të kësaj Konvente, organizata dhe shtetet anëtare të saj vendosin për përgjegjësitë e tyre përkatëse për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas Konventës. Në raste të tilla, organizata dhe shtetet anëtare nuk kanë të drejtën të ushtrojnë njëkohësisht të drejtat sipas Konventës.

3. Në instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, një organizate rajonale e integrimit ekonomik deklaron shkallën e saj të kompetencës në lidhje me çështjet që rregullohen nga kjo Konventë. Çdo organizatë e tillë njofton gjithashtu depozitarin, i cili nga ana e vet informon palët për çdo modifikim përkatës në shtrirjen e kompetencave të saj.

Neni 26

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjete pas datës së depozitimit të instrumentit të pesëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet ose organizatë rajonale të integrimit ekonomik që ratifikon, pranon ose miraton këtë Konventë ose aderon në të pas depozitimit të instrumentit të pesëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit nga shteti ose organizata rajonale e integrimit ekonomik të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

3. Për qëllime të paragrafit 1 dhe 2, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integrimit ekonomik nuk konsiderohet si shtojcë e instrumenteve të depozituar nga shtetet anëtare të kësaj organizate.

Neni 27

Rezervat

Asnjë rezervë nuk mund t'i bëhet kësaj Konvente.

Neni 28

Tërheqja

1. Në çdo kohë, tre vjet pas datës në të cilën kjo Konventë ka hyrë në fuqi për një palë, ajo palë mund të tërhiqet nga Konventa duke i dhënë depozitarit njoftim me shkrim.

2. Çdo tërheqje e tillë hyn në fuqi një vit pas marrjes nga depozitari të njoftimit për tërheqjen ose në një datë të mëvonshme që mund të caktohet në njoftimin e tërheqjes.

Neni 29

Depozitari

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara është depozitari i kësaj Konvente.

Neni 30

Tekstet autentike

Origjinali i kësaj Konvente, ku tekstet ne gjuhën arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle të të cilit janë njëlloj autentike, depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Roterdam në ditën e dhjetë të shtatorit, një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë.

SHTOJCA 1

KËRKESAT E INFORMIMIT PËR NJOFTIMET E BËRA SIPAS NENIT 5

Njoftimet përfshijnë:

1. Vetitë, identifikimin dhe përdorimet

a) Emrin e zakonshëm;

b) Emrin kimik sipas një nomenklature të njohur ndërkombëtarisht (për shembull, Unioni Ndërkombëtar i Kimisë së Aplikuar dhe të Pastër (IUPAC), ku ekziston një nomenklaturë e tillë;

c) Markat tregtare dhe emrat e preparateve;

d) Numrat e kodeve: Numri i Shërbimit Abstrakt të Kimikateve (CAS), kodi doganor i Sistemit të Harmonizuar dhe numrat e tjerë;

e) Informacionin mbi klasifikimin e rrezikut, ku kimikati u nënshtrohet kërkesave ë klasifikimit;

f) Përdorimi ose përdorimet e kimikatit;

g) Vetitë fiziko- kimike, toksikologjike dhe ekotoksikologjike.

2. Masat rregulluese përfundimtare

a) Informacioni specifik për masat rregulluese përfundimtare:

(i) Përmbledhje e masave rregulluese përfundimtare;

(ii) Referencë për dokumentin rregullator;

(iii) Data e hyrjes në fuqi të masës rregulluese përfundimtare;

(vi) Treguesi nëse masa rregulluese përfundimtare është ndërmarrë mbi bazën e një vlerësimi të rrezikut ose rrezikshmërisë dhe nëse po, informacionin mbi një vlerësim të tillë që mbulon një referencë për dokumentacionin përkatës;

(v) Arsyet për masën rregulluese përfundimtare në lidhj e me shëndetin e njerëzve, duke përfshirë shëndetin e konsumatorëve dhe punëtorëve, ose mjedisin;

(vi) Përmbledhje mbi rreziqet dhe rrezikshmërinë që paraqesin kimikatet në lidhje me shëndetin e njerëzve, duke përfshirë shëndetin e konsumatorëve dhe punëtorëve ose mjedisin dhe efektet e pritshme të masës rregulluese përfundimtare;

b) Kategoria ose kategoritë ku masa rregulluese përfundimtare është ndërmarrë dhe për çdo kategori:

(i) Përdorimi ose përdorimet e ndaluara nga masa rregullatore përfundimtare;

(ii) Përdorimi ose përdorimet që lejohen;

(iii) Vlerësimi, kur është e mundur, i sasive të kimikatit të prodhuar, importuar, eksportuar dhe përdorur;

c) Një tregues, në masën e lidhjes së mundshme të masave rregulluese përfundimtare me shtetet dhe rajonet e tjera;

d) Informacioni tjetër përkatës që mund të përfshijë:

(i) Vlerësimin e efekteve social-ekonomike të masave rregulluese përfundimtare;

(ii) Informacion mbi alternativat dhe rreziqet që lidhen me to, kur është e mundur, si për shembull:

- Strategjitë e administrimit të integruar të produkte për mbrojtjen e bimëve;

- Praktikat dhe proceset industriale duke përfshirë teknologjinë e pastruesve.

SHTOJCA II

KRITERET PËR FUTJEN NË LISTË TË KIMIKATEVE TË NDALUARA OSE RREPTËSISHT TË KUFIZUARA NË SHTOJCËN III

Gjatë rishikimit të njoftimeve të dorëzuara nga Sekretariati, në përputhje me paragrafin 5 të nenit 5, Komiteti i Rishikimit të Kimikateve:

a) Konfirmon se masa rregulluese përfundimtare është ndërmarrë për të mbrojtur shëndetin e njerëzve ose mjedisin;

b) Vendos që masa rregulluese përfundimtare është ndërmarrë si pasojë e vlerësimit të një rreziku. Ky vlerësim bazohet mbi shqyrtimin e të dhënave shkencore në kontekstin e kushteve mbizotëruese tek pala në fjalë. Për këtë qëllim, dokumentacioni i dhënë tregon se:

(i) të dhënat janë nxjerrë sipas metodave të njohura shkencërisht;

(ii) shqyrtimi i të dhënave është kryer dhe dokumentuar sipas parimeve dhe procedurave shkencore të njohura përgjithësisht;

(iii) masa rregulluese përfundimtare është bazuar mbi një vlerësim rreziku që përfshin kushtet mbizotëruese brenda Palës që ndërmerr masën;

c) Merr në konsideratë nëse masa rregulluese përfundimtare siguron një bazë të gjerë të mjaftueshme që ta justifikojë renditjen e kimikatit në shtojcën III, duke marrë parasysh:

(i) nëse masa rregulluese përfundimtare ka çuar ose pritej të çonte në një ulje të konsiderueshme të sasisë së kimikatit të përdorur ose numrin e përdorimeve të tij;

(ii) nëse masa rregulluese përfundimtare ka çuar në një zvogëlim të rrezikut ose pritej të çonte në një zvogëlim të konsiderueshëm të rrezikut për shëndetin e njerëzve ose mjedisin e palës që ka dorëzuar njoftimin;

(iii) nëse faktorët që kanë çuar në marrjen e një mase rregulluese përfundimtare janë të zbatueshëm vetëm në një zonë gjeografike të kufizuar ose në rrethana të tjera të kufizuara;

(iv) nëse ka të dhëna për vazhdimin e tregtisë ndërkombëtare të kimikatit;

d) merr parasysh se keqpërdorimi i qëllimshëm nuk është në vetvete një arsye e mjaftueshme për të renditur një kimikat në shtojcën III.

SHTOJCA III 1

KIMIKATET QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS SË NJOFTIMIT TË PËLQIMIT PARAPRAK

KIMIKATI NUMRI(NUMRAT) PËRKATËS CAS KATEGORIA

2,4,5,-T dhe kripërat dhe esterat e saj 93-76-5* Produkt për mbrojtjen e bimëve

Aldrin 309-00-2 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Binapakril 485-31-4 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Kaptafol 2425-06-1 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Klordan 57-74-9 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Klorodimeform 6164-98-3 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Klorobenzilat 510-15-6 Produkt për mbrojtjen e bimëve

DDT 50-29-3 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Dieldrin 60-57--1 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Dinitro-orto-kresol (DNOC) dhe kripërat e saj (si për shembull kripe amoni, kripe kaliumi dhe kripe sodiumi) 534-52-1 2980-64-5 5787-96-2 2312-76-7 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Dinoseb dhe kripërat dhe esterat e saj 88-85-7* Produkt për mbrojtjen e bimëve

1,2-dibromoetan(EDB) 106-93-4 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Diklorid etileni 107-06-2 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Oksid etileni 75-21-8 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Fluoroacetamid 640-19-7 Produkt për mbrojtjen e bimëve

HCH (izomere te përzier) 608-73-1 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Heptaklor 76-44-8 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Heksaklorobenzine 118-74-1 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Lindan 58-89-9 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Përbërës të Mërkurit, duke përfshirë Përbërës inorganikë Të mërkurit, përbërësit alkil të mërkurit dhe përbërësit alkiloksialkil dhe aril te merkurit Produkt për mbrojtjen e bimëve

_____

1 E ndryshuar nga Mbledhja e Parë e Konferencës së Palëve me vendimin e saj RC/1/3 e 24 shtatorit 2004

Monokrotofos 6923-22-4 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Paration 56-38-2 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Pentaklorofenol dhe kripërat dhe esteret e tij 87-86-5* Produkt për mbrojtjen e bimëve

Tok safen 8001-35-2 Produkt për mbrojtjen e bimëve

Formula pluhuri që përmbajnë një kombinim të:

-Benomilit ne ose mbi 7 për qind, -Karbofuran në ose mbi 10 për qind, -Tiram ne ose mbi 15 për qind 17804-45-2

1563-66-2

137-26-8 Formulë produkti për mbrojtjen e bimëve tepër të rrezikshëm

(1) Monokrotofos (Formula Të tretshme në lëngje të substancës që tejkalon 600 gr. përbërës aktiv/1) 6923-22-4 Formule produkti për mbrojtjen e bimëve tepër te rrezikshëm

Metamidofos (formula të tretshme në lëngje të substancës që tejkalon 600 gr. përbërës aktiv/1) 10265-92-6 Formule produkti për mbrojtjen e bimëve tepër te rrezikshëm

Fosfamidon (formula të tretshme në lëngje të substancës që tejkalon 1000 gr.përbërës aktiv/1) 13171-21-6 (përzierje, (E)& (Z) izomere 23783-98-4 (Z) (izomer) 297-99-4 (E) (izomer) Formule produkti për mbrojtjen e bimëve tepër te rrezikshëm

Metil- paration (koncentrate emulsive (EC) në ose mbi 19.5 % përbërës aktivë dhe pluhura që përmbajnë në ose mbi 1.5% përbërës aktive) 298-00-0 Formule produkti për mbrojtjen e bimëve tepër te rrezikshëm

(1)Paration (të gjitha formulat- aerosol, pudër pluhurosës (DP), koncentrat emulsiv (EC), grimca (GR), dhe pudra të lagura (WP)-të kësaj substance janë përfshirë, me përjashtim të suspensoideve kapsule

(CS) 56-38-2 Formule produkti për mbrojtjen e bimëve tepër te rrezikshëm

Azbest:

-Aktinolit

-Antofilit

-Amosit

-Krocidolit

-Tremolit

77536-66-4

77536-67-5

12172-73-5

12001-28-4

77536-68-6

Industrial

Industrial

Industrial

Industrial

Industrial

Bifenile të polibrominuar (PBB) 36355-01-8 (heksa-) 27858-07-7 (okta-) 13654-09-6 (deka-) Industrial

Bifenile të poliklorinuar (PCB) 1336-36-3 Industrial

Terfenile te poliklorinuar (PCT) 61788-33-8 Industrial

Plumb tetraetilik 78-00-2 Industrial

Plumb tetrametilik 75-74-1 Industrial

Tris (2,3-dibromopropil) fosfat 126-72-7 Industrial

*Vetëm numrat CAS të përbërësve prindër janë renditur. Për një listë të numrave të tjerë përkatës të CAS, mund t'i referohet dokumentit përkatës udhëzues të vendimit. (1) Amendament që hyn në fuqi më 1 janar 2006.

SHTOJCA IV

INFORMACIONE DHE KRITERE PËR PËRFSHIRJEN NË LISTË TË FORMULAVE TË PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE TEPËR TË RREZIKSHME NË SHTOJCËN III

Pjesa 1. Dokumentacioni i kërkuar nga një palë propozuese

Propozimet e paraqitura sipas paragrafit 1 të nenit 6 përfshijnë dokumentacionin e mjaftueshëm që përmban informacionin e mëposhtëm:

a) Emrin e formulës së produktit për mbrojtjen e bimëve të rrezikshme;

b) Emrin e përbërësit ose përbërësve aktive në formulë;

c) Sasinë relative te çdo përbërësi aktiv në formulë;

d) Llojin e formulës;

e) Emrat tregtare dhe emrat e prodhuesve, nëse ka;

f) Modelet e zakonshme dhe të njohura të përdorimit të një formule brenda palës propozuese;

g) Një përshkrim të qartë të incidenteve që lidhen me problemin, duke përfshirë efektet negative dhe mënyrën në të cilën është përdorur formula;

h) Çdo masë rregulluese, administrative ose mase tjetër të marrë ose që synohet të merret nga pala propozuese në përgjigje të incidenteve të tilla.

Pjesa 2. Informacioni që duhet të mblidhet nga Sekretariati

Sipas paragrafit 3 të nenit 6, Sekretariati mbledh informacionin përkatës që lidhet me formulën, duke përfshirë:

a) Vetitë fiziko-kimike, toksikologjike dhe ekotoksikologjike të formulës;

b) Ekzistencën e kufizimeve për transportim dhe aplikim në shtetet e tjera;

c) Informacion mbi incidentet që lidhen me formulën në shtetet e tjera;

d) Informacion të dorëzuar nga palët e tjera, organizata ndërkombëtare, organizata joqeveritare ose burime të tjera përkatëse, qoftë kombëtare apo ndërkombëtare;

e) Vlerësimin e rrezikut dhe/ose rrezikshmërisë, kur është e mundur;

f) Treguesit, nëse është e mundur, e shkallës së përdorimit të formulës, si për shembull numri i regjistrimeve ose prodhimit, ose sasia e shitjeve;

g) Formula të tjera të produktit për mbrojtjen e bimëve në fjalë, dhe incidentet, nëse ka, në lidhje me këto formula;

h) Praktikat alternative të kontrollit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;

i) Informacione të tjera që Komiteti i Rishikimit të Kimikateve mund t'i identifikojë si të nevojshme.

Pjesa 3. Kriteret për përfshirjen në listë të formulave të produktit për mbrojtjen e bimëve tepër të rrezikshëm në shtojcën III

Gjatë rishikimit të propozimeve të bëra nga Sekretariati sipas paragrafit 5 të nenit 6, Komiteti i Rishikimit të Kimikateve merr në konsideratë:

a) Besueshmërinë e të dhënave që tregojnë se përdorimi i formulës, në përputhje me praktikat e zakonshme ose të njohura brenda palës propozuese, të rezultuara në incidentet e raportuara;

b) Lidhjen e këtyre incidenteve me shtete të tjera me klimë, kushte dhe mënyra të ngjashme të përdorimit të formulës;

c) Ekzistencën e kufizimeve të transportimit ose aplikimit të tyre, duke përfshirë teknologjinë ose teknikat që mund te mos aplikohen gjerësisht ose në mënyrë të arsyeshme në shtetet që nuk kanë infrastrukturën e nevojshme;

d) Rëndësinë e efekt eve të raportuara në lidhje me sasinë e formulës së përdorur;

e) Keqpërdorimi i qëllimshëm nuk është në vetvete një arsye e mjaftueshme për ta përfshirë formulën në listën e shtojcës III.

SHTOJCA V

KËRKASAT PËR INFORMACION MBI NJOFTIMET E EKSPORTIT

1. Njoftimet e eksportit përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) Emrin dhe adresën e autoriteteve kombëtare përkatëse të caktuara të palës eksportuese dhe palës importuese;

b) Datën e pritshme të palës importuese;

c) Emrin e kimikatit të ndaluar ose rreptësisht të kufizuar të kimikatit dhe një përmbledhje të informacionit të specifikuar në shtojcën I që duhet t'i jepen Sekretariatit në përputhje me nenin 5. Kur më shumë se një kimikat është përfshirë në një përzierje ose preparat, informacioni jepet për çdo kimikat;

d) Një deklaratë që tregon, nëse dihet, kategorinë e parashikuar të kimikatit dhe përdorimin e parashikuar të tij brenda asaj kategorie në palën importuese;

e) Informacion mbi masat parandaluese për të zvogëluar ekspozimin dhe emetimin e kimikatit;

f) Në rastin e një përzierjeje ose preparati, përqendrimin e kimikatit ose kimikateve në fjalë, të ndaluar ose rreptësisht të kufizuar;

g) Emrin dhe adresën e importuesit;

h) Çdo informacion shtesë që vihet lehtësisht në dispozicion për autoritetin kombëtar përkatës të caktuar të palës eksportuese që do të ishte i dobishëm për autoritetin kombëtar të caktuar të palës importuese.

2. Përveç informacionit të përmendur në paragrafin 1, pala eksportuese siguron informacione të tjera të mëtejshme të specifikuara në Shtojcën I, siç mund të kërkohen nga Pala importuese.

SHTOJCA VI 2

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

A. Rregullat e arbitrazhit

Procedura e arbitrazhit për qëllime të paragrafit 2 (a) të nenit 20 të Konventës së Roterdamit mbi procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe produkte për mbrojtjen e bimëve të rrezikshme në tregtinë ndërkombëtare është si më poshtë:

Neni 1

1. Një nga palët mund të bëjë rekurs në arbitrazh në përputhje me nenin 20 të Konventës duke njoftuar me shkrim Palën tjetër të mosmarrëveshjes. Njoftimi shoqërohet me një deklaratë të kërkesëpadisë, bashkë me dokumente të tjera mbështetëse dhe cilëson objektin e çështjes për arbitrazh duke përfshirë në veçanti, nenet e Konventës rreth të cilave bëhet interpretimi ose zbatimi.

2. Pala paditëse njofton sekretariatin që palët i janë drejtuar arbitrazhit në lidhje me një mosmarrëveshje sipas nenit 20. Njoftimi me shkrim i palës paditëse shoqërohet me deklaratën e kërkesëpadisë dhe dokumentet e tjera mbështetëse të përmendura në paragrafin 1 më sipër. Sekretariati i shpërndan informacionin e marrë të gjitha palëve.

Neni 2

1. Në rast të një mosmarrëveshje ndërmjet dy palëve caktohet një gjykatë arbitrazhi. Ajo përbëhet nga tre anëtarë.

_____

2 Miratuar nga Mbledhja e Parë e Konferencës së Palëve me vendimin e saj RC I/II të 24 shtatorit 2004.

2. Secila palë e mosmarrëveshjes cakton një arbitër dhe të dy arbitrat e zgjedhur nga palët caktojnë me marrëveshje një arbitër të tretë, i cili do të jetë Kryetari i Gjykatës. Kryetari i Gjykatës nuk duhet të jetë shtetas i njërës prej palëve të mosmarrëveshjes, as nuk duhet të ketë vendbanimin e tij ose të saj të zakonshëm në territorin e njërës prej palëve, dhe as të jetë i punësuar prej tyre apo të ketë shqyrtuar çështje në ndonjë cilësi tjetër.

3. Në rast të mosmarrëveshjeve ndërmjet më shumë se dy palëve, palët me interes të përbashkët caktojnë bashkërisht me marrëveshje një arbitër.

4. Çdo vend bosh plotësohet sipas mënyrës së parashikuar për emërimin fillestar.

5. Nëse palët nuk bien dakord për çështjen objekt i mosmarrëveshjes para caktimit të Kryetarit të Gjykatës së Arbitrazhit, Gjykata e Arbitrazhit merr vendim për çështjen.

Neni 3

1. Nëse një nga Palët e mosmarrëveshjes nuk cakton një arbitër brenda dy muajve nga dita në të cilën pala e paditur merr njoftimin e arbitrazhit, pala tjetër informon Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara i cili do të bëjë caktimin brenda një periudhe dymujore.

2. Nëse Kryetari i Gjykatës së Arbitrazhit nuk është caktuar brenda dy muajve nga data e caktimit të arbitrit të dytë, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të caktojë Kryetarin e Gjykatës brenda një periudhe dy mujore, me kërkesën e një Pale.

Neni 4

Gjykata e Arbitrazhit merr vendimet në përputhje me dispozitat e Konventës dhe të drejtën ndërkombëtare.

Neni 5

Përveç kur palët e mosmarrëveshjes bien dakord ndryshe, Gjykata e Arbitrazhit vendos rregullat e veta të procedurës.

Neni 6

Gjykata e Arbitrazhit mund të rekomandojë me kërkesën e njërës prej palëve, masa të nevojshme të përkohshme mbrojtëse.

Neni 7

Palët e mosmarrëveshjes lehtësojnë punën e Gjykatës së Arbitrazhit dhe, në veçanti, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion të tyre:

a) i japin asaj të gjithë dokumentacionin, informacionin dhe shërbimet përkatëse; dhe

b) t'i mundësojnë asaj, nëse është e nevojshme, të t hërrasë dëshmitarë ose ekspertë dhe të marrë dëshmitë e tyre.

Neni 8

Palët dhe arbitrat kanë detyrimin për të ruajtur fshehtësinë e çdo informacioni që marrin në mirëbesim gjatë procedimeve të Gjykatës së Arbitrazhit.

Neni 9

Në rast se Gjykata e Arbitrazhit vendos ndryshe për shkak të rrethanave të veçanta të çështjes, shpenzimet e Gjykatës ndahen në mënyrë të barabartë nga palët e mosmarrëveshjes. Gjykata regjistron të gjitha shpenzimet dhe i dërgon palëve një raport përfundimtar të tyre.

Neni 10

Pala që ka interes të një natyre ligjore në lidhje me çështjen e mosmarrëveshjes që mund të cenohet nga vendimi i marrë për këtë çështje, mund të ndërhyjë gjatë procedimeve, me pëlqimin e Gjykatës së Arbitrazhit.

Neni 11

Gjykata e Arbitrazhit mund të dëgjojë dhe të vendosë kundërpaditë e ngritura drejtpërdrejt nga çështja në fjalë.

Neni 12

Vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit si për procedurën dhe përmbajtjen, merren me shumicën e votave të anëtarëve të saj.

Neni 13

1. Nëse njëra nga palët e mosmarrëveshjes nuk paraqitet para Gjykatës së Arbitrazhit ose nuk arrin të mbrojë çështjen e saj, pala tjetër mund t'i kërkojë Gjykatës të vazhdojë procedimet dhe të marrë vendimin. Mungesa e një pale ose pamundësia e saj për të mbrojtur çështjen nuk përbën pengesë për vazhdimin e procedimeve.

2. Para marrjes së vendimit të formës së prerë, Gjykata e Arbitrazhit duhet të bindet që padia është e bazuar në fakte dhe në ligj.

Neni 14

Gjykata e Arbitrazhit merr vendim të formës së prerë brenda pesë muajve nga data kur është ngritur Gjykata e Arbitrazhit nëse nuk e çmon të nevojshme të zgjasë afatin kohor për një periudhë e cila nuk duhet të kalojë edhe pesë muaj të tjerë.

Neni 15

Vendimi i formës së prerë të Gjykatës së Arbitrazhit kufizohet në thelbin e mosmarrëveshjes dhe deklaron arsyet ku bazohet. Ai përmban emrat e anëtarëve që kanë marrë pjesë në të, si edhe datën kur është marrë vendimi i formës së prerë. Çdo anëtar i Gjykatës së Arbitrazhit mund të bashkëlidhë një mendim të veçantë ose kundërshtues të vendimit të formës së prerë.

Neni 16

Vendimi është i detyrueshëm për të palët e mosmarrëveshjes. Interpretimi i Konventës i dhënë nga vendimi është i detyrueshëm për palën që ndërhyn, sipas nenit 10, në masën që ka lidhje me çështjet në lidhje me të cilat ka ndërhyrë ajo palë. Vendimi nuk apelohet nëse palët e mosmarrëveshjes nuk kanë rëne dakord më parë për procedurën e apelimit.

Neni 17

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga marrja e vendimit të formës së prerë në përputhje me nenin 16 më sipër, në lidhje me interpretimin ose mënyrën e zbatimit të vendimit, mund të paraqitet nga ndonjë prej tyre për vendim në Gjykatën e Arbitrazhit që e ka marrë atë.

B. Rregulla mbi pajtimin

Procedura e pajtimit për qëllime të paragrafit 6, neni 20 i Konventës, janë si më poshtë.

Neni 1

1. Kërkesa nga njëra pale e mosmarrëveshjes për të ngritur një komision pajtimi në vijim të paragrafit 6 të nenit 20, i dërgohet Sekretariatit me shkrim. Sekretariati njofton menjëherë të gjitha Palët në përputhje me rrethanat.

2. Komisioni i pajtimit përbëhet nga pesë anëtarë nëse palët nuk bien dakord ndryshe, dy të emëruar nga secila palë e interesuar dhe një Kryetar i zgjedhur bashkërisht nga ata anëtarë.

Neni 2

Në rast të mosmarrëveshjeve ndërmjet më shumë se dy palëve, palët me të njëjtat interesa i zgjedhin anëtarët e komisionit bashkërisht me marrëveshje.

Neni 3

Nëse palët nuk takohen brenda dy muajve nga data e marrjes së kërkesës me shkrim nga Sekretariati i përmendur në nenin 1, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, me kërkesë të një pale, cakton takimet e nevojshme brenda dy muajve të ardhshëm.

Neni 4

Nëse Kryetari i komisionit të pajtimit nuk është zgjedhur brenda dy muajve nga data e caktimit të anëtarit të katërt të komisionit, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara cakton Kryetarin brenda dy muajve të ardhshëm.

Neni 5

1. Komisioni i pajtimit përcakton rregullat e veta te procedurës në rast se palët e mosmarrëveshjes nuk bien dakord ndryshe.

2. Palët dhe anëtarët e Komisionit kanë detyrimin të mbrojnë fshehtësinë e çdo informacioni që marrin në mirëbesim gjatë procedurave të komisionit.

Neni 6

Komisioni i pajtimit i merr vendimet me shumicë votash nga anëtarët e tij.

Neni 7

Komisioni i pajtimit përpilon një raport me rekomandime për zgjidhjen e mosmarrëveshjes brenda dymbëdhjetë muajve nga koha kur është ngritur, të cilën palët e marrin në konsideratë në mirëbesim.

Neni 8

Çdo mosmarrëveshje për të cilën komisioni i pajtimit ka kompetencë për të marrë në shqyrtim një çështje që i referohet asaj, vendoset nga komisioni.

Neni 9

Shpenzimet e Komisionit shlyhen nga palët e mosmarrëveshjes, siç bien dakord ndërmjet tyre. Komisioni regjistron të gjitha shpenzimet dhe përpilon një deklaratë përfundimtare për to drejtuar palëve.